



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01– Nr. 400-12114/11
Kaçanik; 29.09.2011.

Në mbështetje të nenit 24 dhe 40.2(b) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 61. të Ligjit nr.03/L-048. – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nenit 2 të Ligjit nr.03/L-049 – Për Financat e Pushtetit Lokal dhe nenit 34.5 lidhur me nenin 61.1 të Statutit të Komunës, më Rekomandim të KPF-a të datës: 22.09.2011 për aprovimin e Buxhetit të Komunës së Kaçanikut për vitin 2012 dhe vlerësimet për vitet: 2013-2014 të propozuara nga Kryetari i Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 29.09.2011, mori këtë:

V E N D I M
PËR BUXHETIN E KOMUNËS SË KAÇANIKUT PËR VITIN FISKAL 2012
DHE VLERËSIMET PËR VITET 2013 - 2014

I

Buxheti total i Komunës së Kaçanikut për vitin buxhetor 2012 është në shumë prej 5,457,754 €, ndërkaq për vitin 2013 vlerësimet e projektuara janë në masë monetare prej 5,528,999 € dhe për vitin 2014 në shumë prej 5,574,176 €.

II

Në strukturën e të hyrave të tërësishme buxhetore për vitin buxhetor 2012., sipas pikes I. të këtij vendimi, mjetet nga Grantet qeveritare janë në shumë prej 4,864,625 €, që shëojnë pjesmarrje me 89,1% dhe të hyrat vetjake komunale, në shumë prej 593,130 €, me një pjesmarrje prej 10,9% në strukturën e përgjithshme të buxhetit.

III

Shpenzimet e përgjithshme buxhetore për vitin buxhetor 2012, parashikohen që të jenë të ndarë për Shpenzime Operative, shuma prej 4,277,565 € dhe për Investime Kapitale, shuma prej 1,180,190 €.

IV.

Shpenzimet buxhetore për vitin 2012, sipas kategorive kryesore të shpenzimeve, parashikohet të kenë këto ndarje:

- | | |
|---|-------------|
| 1. Shpenzimet për Paga dhe Mëditje | 3,761,520 € |
| 2. Shpenzimet e Mallrave dhe Shërbimeve | 402,045 € |
| 3. Shpenzimet e Shërbimeve Komunale | 84,000 € |
| 4. Subvencionet dhe Transferet | 30,000 € |
| 5. Shpenzimet në Investime Kapitale | 1,180,190 € |

V

Për zbatimin dhe rishikimin e këtij vendimi për buxhetin e komunës, obligohet Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.

VI

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e aprovimit dhe do të vlejë për deri sa nuk merret ndonjë vendim tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit,
z. Xhelal Gashi
